



**KUVENDI
KOMISIONI PËR POLITIKËN E JASHTME**

Dokument parlamentar

RAPORT
(Për dhënie mendimi)

**PËR
PROJEKTLIGJIN**

**“PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT TË GJASHTË SHITESË TË MARRËVESHJES
PËR FORCËN SHUMËKOMBËSHE TË PAQES NË EVROPËN JUGLINDORE”**

➤ **HYRJE**

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës, Komisioni për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit prezantuan projektligjin Z. Petro Koçi, Zëvendësministër i Mbrojtjes, Z. Gjergj Methoxha, Drejtor i Politikave NATO dhe BE dhe përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes.

Relatore për këtë projektligj ishte deputetja Znj. Elona Gjebrea.

➤ **BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i këtij protokollit bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

➤ QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji “Për Ratifikimin e protokollit të gjashtë shtesë të marrëveshjes për Forcën Shumëkombëshe të Paqes në Evropën Juglindore” ka për qëllim ratifikimin e protokollit të gjashtë shtesë të marrëveshjes për Forcën Shumëkombëshe të Paqes në Evropën Juglindore.

Në kuadrin e marrëveshjes të Forcave Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Evropës Juglindore {Multinational Peacekeeping Force South Eastern Europe (MPFSEE)}, e cila është nënshkruar në Shkup, më 26 shtator 1998, dhe pesë protokolleve të saj shtesë, është hartuar dhe është përgatitur për nënshkrim protokollit i gjashtë shtesë.

Ky protokoll është miratuar, në parim, me vendimin nr.673, datë 7.11.2018, të Këshillit të Ministrave dhe synon përmirësimin e marrëveshjes bazë, pasi është gjykuar se nevojitet më shumë fleksibilitet në vendimet që merren, për sa i përket mënyrës se si funksionon Forca Shumëkombëshe e Evropës Juglindore (MPFSEE) dhe brigada e saj SEEBRIG.

Krijimi i kësaj Force, në nivelin fillestar të një brigade shumëkombëshe (SEEBRIG), u vlerësua si një mundësi e mirë përgatitjeje e personelit të Forcave të Armatosura të secilit shtet, për të qenë të gatshëm për të vepruar më pas, në kuadër të misioneve të NATO-s apo OKB-së.

Gjatë viteve ndryshimet e nevojshme në lidhje me MPFSEE janë pasqyruar në hartimin e pesë protokolleve shtesë, ndryshime të cilat kanë ndikuar në mënyrën e funksionimit dhe strukturën e MPFSEE-së, duke rritur cilësinë e bashkëpunimit mes shteteve.

Të njëjtin efekt pritet të ketë edhe miratimi i protokollit të gjashtë shtesë, i cili synon rritjen e fleksibilitetit dhe ndërveprimit me njësitë e tjera në operacione të NATO-s, BE-së dhe OKB-së.

Projektligji nuk do të ketë asnjë efekt shtesë në buxhetin e shtetit, përveç detyrimeve të ndërmarra që në anëtarësimin fillestar në vitin 2000.

➤ DISKUTIME NË KOMISION

Gjatë prezantimit të projektligjit zëvendësministri Z. Koçi, sqaroi se ndryshimet e marrëveshjes dhe protokollit i gjashtë shtesë nuk prekin thelbin e saj, pra parimet mbi të cilat funksionon MPFSEE-ja dhe qëllimi për të cilën ajo u krijua. Pas pyetjeve të deputetëve, anëtarë të komisionit ai dha sqarime lidhur me ndikimet konkrete që do të sjellë ratifikimi i protokollit të gjashtë shtesë për Shqipërinë, në kuadër të detyrimeve ndaj BE-së, NATO-s dhe OKB-së.

Relatorja për projektligjin Znj. Gjebrea theksoi se Forca Paqeruajtëse Shumëkombëshe e Evropës Juglindore (MPFSEE) ka si qëllim të ndikojë në sigurimin e stabilitetit rajonal dhe kultivimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore.

➤ **PËRFUNDIME**

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim, Komisioni për Politikën e Jashtme votoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

RELATORE
ELONA GJEBREA

KRYETARE
MIMI KODHELI